



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 28 qershor 2019, në mbledhjen e XXI (njëzetënjë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (Lista e nënshkrimeve), përveç znj.Fatlume Jaha e cila mungoi,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OJQ-ve lokale (Rrjet i OJQ Lokale), përfaqësues të mjeteve të informimit dhe mediave, dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj për pikat e rendit të propozuar të ditës dhe konstatimeve nga mbledhja e KPF-së. Nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse nuk ka e vë në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar dhe konstatimeve nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas materialit të dërguar dhe konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 26 qershor 2019.

1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 maj 2019

Njëzëri, sipas materialit të dërguar, u miratua Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më 31 maj 2019

2. Korniza Afatmesme Buxhetore – KAB 2020/2022 e Komunës së Podujevës

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore - KAB 2020/2022 e Komunës së Podujevës është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve -KASH të Republikës së Kosovës, e cila është ndërtuar në përputhje me procedurat buxhetore të dhëna nga Ministria e Financave - MF përmes Qarkores Buxhetore 2020/01, dokument në të cilin janë përcaktuar kufijtë fillestar buxhetor për Komunën e Podujevës dhe atë në shumë 23,956,419.00€ për vitin 2020, duke u ndarë në; granti për

Administratë të përgjithshme në shumë 9,292,820.00€, granti për Arsim 10,308,367.00€, granti për Shëndetësi 2,938,671.00€ si dhe të hyra vetanake 1,416,561.00€.

Nëse bëjmë një krahasim me buxhetin aktual të vitit 2019, kemi një ngritje prej 1,923,800.00€, ngritje kjo e cila do të reflektojë sidomos te kategoria paga dhe mëditje me aplikimin e ligjit për paga të Administratës Publike. Projektionet buxhetore për vitin 2021 janë në shumë 24,729,850.00€, kurse në vitin 2022 25,579,907.00€.

Gjithashtu KAB paraqet një mjet të procesit të zhvillimit të buxhetit që bënë ndarjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve Komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare, si dhe në këtë dokument paraqiten shpjegimet e politikave – prioritetëve të tanishme dhe atyre afatmesme të Komunës së Podujevës si dhe projektionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritetet e përcaktuara për vitet 2020-2022, duke përfshirë edhe objektivat të cilat synohen të arrihen për periudhën e cekur, si vijon: -Krijimi i ambientit të përshtatshëm për biznese, -Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe fshatit, -Zhvillim i qëndrueshëm hapësinorë dhe urban, -Përmirësimi i infrastrukturës fizike, -Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe nivelit të mirëqenies sociale, si dhe -Sigurimi dhe ngritja e cilësisë në arsim.

Korniza Afatmesme Buxhetore reflekton perspektivën e politikave makro-fiskale sa i përket parashikimit të të hyrave vetanake sipas llojeve të të hyrave, si dhe parashikimit të shpenzimeve buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike. Përmes këtij dokumenti jemi munduar që në mënyrë të qartë të paraqesim deklaratë të aktiviteteve, misionëve dhe objektiveve të Komunës për secilën Drejtori, e që secila ka një përmbledhje të aktiviteteve të nevojshme për të arritur misionin ose qëllimin e saj, strategji për të arritur aktivitetet e nevojshme që vlerësohen edhe rreziqet gjatë periudhës buxhetore dhe një plan të përgjithshëm për të adresuar rreziqet.

Në fushën e shpenzimeve, në KAB është përfshirë një projektion tre vjeçar i shpenzimeve të cilat mund të financohen nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Shpenzimet janë projektuar sipas Drejtorive gjegjësisht programeve dhe sipas kategorive të shpenzimeve siç janë: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, komunalit, subvencionet dhe kapitale, e që shpenzimet e parashikuara baraspeshohen me të hyrat e parashikuara.

Çdo Drejtori ka një masë të performances, masa të cilat janë të adresuara dhe në fund ato përmirësohen. Mandej në KAB janë trajtuar në mënyrë të veçantë projektet për investime kapitale për periudhën tre vjeçare, fushë kjo e cila i prekë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Komunës së Podujevës. Lista e projekteve është e ndarë në tri vitet e ardhshme sipas periudhës për të cilën mendojmë që mund të plotësohen këto projekte të cilat mund të financohen nga granti qeveritar si dhe nga të hyrat vetanake, pa përjashtuar mundësinë e financimit edhe nga donatorët e mundshëm qoftë të brendshëm apo të jashtëm.

Të nderuar këshilltar, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka planifikuar 35 projekte për vitin 2020 me një shumë prej 3,633,599.00€, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit ka planifikuar 20 projekte me një shumë prej 1,780,000.00€, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka planifikuar 8 projekte me një shumë prej 666,930.00€, Drejtoria e Arsimit 5 projekte me një shumë prej 574,419.00€, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 3 projekte me një shumë prej 60,000.00€, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik 3 projekte me 160,000.00€. Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 2 projekte kapitale si dhe 6 projekte të në subvencione me një shumë totale prej 496,350.00€, si dhe Drejtoria e Administratës ka planifikuar një projekt në shumë 28,000.00€, e që në total parashikimi prej 8,686,524.00€, që i bie 34% e buxhetit të planifikuar për vitin 2020, gjithnjë duke pasë parasysh që kemi të bëjmë për një dokument kornizë.

Po ashtu duke pas parasysh që ky dokument i KAB 2020/2022 është hartuar në bazë të kufijve fillestar të Qarkores 2020/01 të Ministrisë së Financave, e që në periudhat e ardhshme pritet që të lëshohet edhe Qarkore 2 apo edhe 3 që do të pasohen, dhe me të cilat sigurisht që do të përcaktohen kufijtë final të buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020, dhe projeksionet për vitet 2021-2022, ku dhe rrjedhimisht në bazë të Qarkores pasuese do të përgatitet edhe buxheti final për vitin 2020 si dhe projeksionet për dy vitet pasuese të Komunës së Podujevës, duke mbete me shpresë se Qarkorja finale e MF-së do të parasheh një buxhet më të favorshëm për Komunën e Podujevës, prandaj të nderuar, ju ftoj që të miratoni këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore 2020/2022, duke përfshirë edhe rekomandimin e Komitetit për Politike dhe Financa, përkatësisht në faqen 21 projekti nr.2 nuk ka shumë fare, e që duhet të jetë; buxheti total 60,000.00€, (50,000€ grand/10,000€ te hyrat vetanake), gabim ky i cili ka shkaktuar çrregullim në tabelë gjatë bartjes nga excel ne word dhe tek projektet me nr.4 dhe nr.5, konkretisht te projekti me nr.4 buxheti duhet jetë 109,124 grand, 30,000 te hyra, totali 139,124 €, ndërsa te projekti me nr.5 buxheti duhet të jetë 150,000 grant, 20,000 te hyra, totali 170,000. Pra edhe përkundër këtyre gabimeve, shuma totale e buxhetit në këtë Drejtori mbetet e njëjtë si në dokumentin që ju është dërguar me material.

Gjithashtu në faqen 28 te Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në projektet për vitin 2021 në shumë prej 110,088.00€, duhet shtuar edhe një projekt i ri i cili në materialin që ju e posedoni nuk figuron, projekti quhet, muze dhe galeri brenda objektit te tanishëm te Komunës, shuma 26,000.00€, prandaj për fund duke kërkuar falje për këto gabime gjatë hartimit të KAB-it, ju ftoj që ta votoni këtë dokument duke përfshirë edhe plotësim – ndryshimet apo të themi korrigjimet e cekura.

z.Mehmet Gashi, theksoi, meqë Drejtori parafoles paraqiti fjalën hyrëse dhe i dha sqarimet dhe arsyet e nevojshme, unë në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së dëshiroj të jap disa sqarime rreth KAB-2020/2022 e cila është pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Republikës së Kosovës dhe e cila duhet të jetë në përputhje me procedurat buxhetore për vitet 2020/2022 të dhëna nga Ministria e Financave përmes Qarkores Buxhetore 2020/01, si dhe në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, e cila duhet të përmbaj strategjitë fiskale të Komunës për periudhën e ardhshme trevjeçare e që shërben si dokument kryesor i planifikimit të Komunës. Bazuar në tabelën me numër rendor 3 tek vlerësimet e hershme buxhetore 2020/2022 buxheti i Komunës së Podujevës ka një ngritje prej 1,923,800.00€ apo 8.7% në krahasim me vitin që jemi, ngritje e cila është si rezultat i ngritjes së pagave që parashihet me Ligjin e ri për paga, pra nga 12,142,542.00€ sa kanë qenë për këtë kategori, tani është rritur në 14,130,981.00€ apo 15.4%, e që përbën 54.8% e buxhetit total të Komunës së Podujevës. Siç jeni në dijeni Ligji për paga ka hyrë në fuqi më 01 mars 2019 kurse zbatimi i tij fillon pas 9 muajve apo më 01dhjetor 2019.

Sa i përket kategorisë mallra dhe shërbime kemi një zvogëlim nga 2,178,773.00€ në 1,814,116.00€ apo 20% krahasuar me vitin 2019, gjë për të cilën mendoj se është pozitive ngase do të ketë kursime në këtë kategori buxhetore. Në kategorinë e komunalive, kemi një ngritje prej 5,236.00€ më shumë se në vitin që jemi. Te kategoria subvencione, gjithashtu kemi një ngritje nga 610,000.00€ në 660,000.00€, kurse tek investimet kapitale kemi një ngritje nga 6,701,304.00€ në 7,063,036.00€ apo për 361,732.00€ (rreth 5.4%) më shumë se në vitin 2019. Ne në cilësinë e anëtarëve të Kuvendit të Komunës do të përqendrohemi më shumë në investimet kapitale dhe do të japim kontributin tonë për Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për vitet 2020/2022.

Pra edhe në mënyrë tabelare i kemi të renditura të gjitha projektet e parapara sipas Drejtorive të paraqitura për tri vitet e ardhshme, por me theks të veçantë për vitin 2020 ngase për vitet 2021/2022 më shumë janë projeksione afatmesme dhe si të tilla mund të rishikohen edhe në vitin e ardhshëm.

Sa i përket projekteve për vitin 2020 vërehet se pothuajse afër 90% të tyre kanë qenë të miratuara në KAB të vitit të kaluar e të parapara për vitin 2020, gjë e cila mendoj se është pozitive ngase janë

projekte të planifikuara, natyrisht duke pas disa ndryshime të vogla si rezultat i investimeve në qytet, andaj në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e mbështesim KAB 2020/2022, dhe i propozojmë Kuvendit miratimin e të njëjtës, duke pas parasysh që buxheti i Komunës miratohet në fund të muajit shtator, dhe ndër kohë do të marrim edhe instruksionin e dytë nga Ministria e Financave ku mund të ketë lëvizje të vogla buxhetore.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve pa dyshim është një prej dokumenteve kryesore që paraqitet për miratim në asamblenë komunale, dhe gjatë këtij mandati të asamblesë kjo është korniza e dytë buxhetore që paraqitet për miratim pas kornizës 2019-2021, pra tani për miratim para vetes e kemi KAB 2020-2022. Ne si LVV edhe për KAB paraprake i kemi dhënë vërejtjet tona qoftë për nivelin e dobët profesional apo edhe për prioritet se kah do të drejtohen mjetet buxhetore për periudhën që parasheh dokumenti në fjalë, mirëpo fatkeqësisht neve si shumë herë po na bien t'i përsërisim vërejtjet tona për arsye se ky pushtet qëndron keq si në aspektin intelektual ashtu edhe në aspektin profesional.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve duhet të ndërtohet në mbështetje të prioriteteve zhvillimore që i ka Komuna, qoftë planin zhvillimor lokal apo strategjitë sektoriale, e që komuna nuk i ka fare.

Në hyrje të këtij dokumenti me të drejtë thuhet se KAB siguron mekanizmat e nevojshëm përmes të cilave, objektivat prioritarë, të identifikuar në dokumentet strategjike të Komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor, mirëpo si të sigurojë mekanizmat që të inkuadrohen në procesin buxhetor objektivat e identifikuar në dokumentet strategjike të Komunës kur nuk ekzistojnë fare këto dokumente. Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal, tani është shpallur fituesi i tenderit në një farsë qesharake për vitin 2019-2021 kur tani veç jemi në gjysmën e vitit 2019 dhe deri të përpilohet kjo strategji, viti 2019 vetëm shkon, ndërsa strategjia e zhvillimit lokal është për vitet 2019-2021, kurse KAB është për vitet 2020-2022, dhe është e përpiluar para strategjisë së zhvillimit lokal që në fakt duhet të jetë e kundërta, mirëpo përveç kësaj strategjie, komuna duhet t'i ketë edhe strategjitë sektoriale si:

1-Strategjia për zhvillimin e bujqësisë, 2-Strategjia për zhvillimin e arsimit, 3-Strategjia për zhvillimin e turizmit, 4- Strategjia për zhvillimin e sportit dhe 5-Strategjia për zhvillimin e kulturës.

Pra ne LVV në orientimet tona programore si forcë e majtë politike, prioritet i japim arsimit, prodhimit vendor, kulturës, sportit, andaj edhe e kundërshtojmë këtë Kornizë e cila vazhdon me logjikën e vjetër duke na bartur probleme të vjetra dhe duke krijuar probleme të reja ekonomiko sociale dhe që nuk ofron perspektiva zhvillimore.

Propozimet tona janë:

1-Ndarje e 500.000.00€ për zonën ekonomik, për arsye se 100,000.00€, janë të pamjaftueshme,

2-Ndarje për çdo vit nga 500,000.00€ për subvencionimin e bizneseve prodhuese (të subvencionohen 10% e makinerive të blera me qëllim të instalimit të linjave të reja prodhuese),

3-Të ndahen 1 milion euro për renovimin e shkollave, kur dihet gjendja shumë e keqe infrastrukturore e objekteve ekzistuese,

4-Të ndahen 200,000.00€ për furnizim të shkollave me kabinetet të shkencave natyrore (fizike, kimi dhe biologji),

5-Të ketë rritje të grandeve në fushën e bujqësisë, grantet për çdo vit të jenë nga 500,000.00 € dhe këto grante të drejtohen në bujqësinë intensive dhe përmes përkrahjes edhe të biznesit prodhues, në fushën e ushqimit të ndihmohet krijimi i një zingjirit të prodhimit.

6-Në fushën e shëndetësisë propozojmë të ndahen mjete për investime për zhvillimin e mjekësisë së patronazhit.

7-Të ketë rritje të buxhetit për furnizime me pajisje dhe inventar për shtëpi të shëndetit, 300,000.00€ në vit të ndahen për këto investime,

8-Të ndahen 300,000.00€ për renovimin dhe adaptimin e objektit aktual te Komunës, me qëllim që të kthehet në bibliotekë të qytetit,

9-Te ndahen 200,000.00€ për subvencionimin e klubeve sportive, kur dihet gjendja shumë e keqe financiare e tyre e që një pjesë e klubeve me traditë në qytetin tonë janë vetëm në një funksion formal,

10-Të ndahen 200,000.00€ për gjelbërimin e qytetit, kur dihet gjendja shumë e keqe e ambientit në qytet, ku qe 20 vite nuk janë mbjellë më shumë se 200 drunjë në qytet, me këto 200 mije euro mund të mbillen shumë drunjë dekorativ e që shumë të nevojshëm për qytetin tone.

Si dhe propozimet tjera që japin ne si LVV, janë;

-Të rregullohet dhe të mirëmbahet parku afër Çerdhes,

-Të rregullohet kopshti i Çerdhes së vetme publike në mënyrë që fëmijët të mos qëndrojnë të mbyllur në këto ditë me vapë.

-Të ndërtohet një çerdhe në fshatin Lluzhan pasi që është e nevojshme për atë lokacion,

-Të ndërtohet një stacion i autobusëve për autobusët e linjës Sfeçël, Balloc, Herticë, pasi që mungon dhe aty ku presin udhëtarët krijohet kaos në trafik.

Pra ne LVV e votojmë këtë KAB, nëse merren parasysh propozimet tona të cilat gjithherë janë në të mirë të qytetarëve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, KAB 2020/2022 është sjellë si dokument për të cilin Drejtori i DBF dhe parafoletit tjerë veç i paraqitën kufijtë buxhetor që janë mbi 22 milion euro për vitin 2020 dhe i gëzohemi faktit që ka ngritje të buxhetit afro 2 milion euro për dallim me vitin aktual, kryesisht ka të bëjë me ngritjen e pagave në sektorin publik, vendim të cilit po ashtu i gëzohemi.

Sa i përket objektivave të parapara nga Ekzekutivi i Komunës për vitin 2020, ashtu siç janë paraparë kërkojmë të realizohen në formën më të mirë të mundshme dhe më cilësore të mundshme për secilin projekt dhe fushë veç e veç. Sigurisht se do të ketë edhe Qarkore Buxhetore tjera që do ta plotësojnë këtë dokument dhe në fund do të jepen finalizimet buxhetore për vitin 2020 dhe planifikimet për dy vitet pasuese. Po ashtu i gëzohemi edhe faktit të ngritjes së buxhetit për subvencione, normal për ata që meritojnë të subvencionohen në çfarëdo sektori apo fushe qofshin, për çka kërkoj që të mbështeten të gjithë ata që meritojnë të subvencionohen në fushat e tyre.

Edhe sa i përket projekteve, nuk mund të themi se janë finale sepse këto mund të ndryshojnë qoftë në miratimin e buxhetit në muajin shtator qoftë me rastin e rishikimit të buxhetit, për arsye se jemi dëshmitar që ka lëvizje të projekteve dhe të situatave të ndryshme e që ne deri në 30% mund t'i ndryshojmë dhe të futen si prioritete për vitin 2020.

Sa i përket organizimit të Strategjive për zhvillim, mendoj se kjo detyrë ose obligim i takon Ekzekutivit të Komunës konkretisht Drejtorive përkatëse që para sjelljes apo implementimit të dokumentit dhe shpenzimit të buxhetit, shpresoj që secili Drejtor para se të sjellë dokumentin dhe planifikimet në fushën e vet të ketë biseduar me secilin, para se të sjellët dokumenti dhe të paraqiten projektet-subvencione etj, sepse jemi në dijeni se në Komunën e Podujevës ekzistojnë Shoqata të ndryshme të cilat ndërlidhen direkt me Drejtorët ekzekutiv kur ata dëshirojnë të japin maksimumin e tyre në mbështetje të zhvillimit të Komunës, duke filluar nga Shoqata e Bizneseve që i takon Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të shikon fushën se si do t'i jap 'infuzion' bizneseve-zhvillimit të tyre, pastaj për shoqata tjera dhe subvencione që ndërlidhen me Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Shoqata e bletarëve), pastaj kemi Komisionet për infrastrukturë që janë të ngritura që të shikohet se cilat projekte janë më të nevojshmet në qytet dhe fshatra, mirëpo si pjesë e komisionit për infrastrukturë nga radhët e PDK-së nuk jam ftuar nga akterët, para se sjelljes së këtij dokumenti që të paktën të merrej mendimi se çfarë duhet të ndërmerret në Komunën tonë, nuk dua të kuptohet kjo që unë do të jepesha më shumë diçka por të

paktën të japim mendime të ndryshme që Podujeva të duket paska më ndryshe se katër vitet që po i lëm pas, gjë për të cilën mendoj se ndoshta është një lëshim teknik apo i disponueshmërisë.

Pastaj jemi në dijeni se janë të themeluara dy komitete konsultative, ku kam qenë edhe pjesë e komisionit përzgjedhës të tyre e që janë përzgjedhur dhe rekomanduar kandidat jashtë politikës, andaj nuk di a janë ftuar ndonjëherë këto dy komitete për bashkë diskutim apo a janë konsultuar ndonjëherë ato dy Komitete për fushat që janë përzgjedhë. Nëse janë bërë konsultime dhe dokumenti kornizë që është, përfshin edhe mendime dhe ide nga diskutime dhe bashkëbisedime me akterë të fushave të ndryshme (bujqësi, sport, kulturë, ekonomi etj, të ngjashme) do të ishte shumë në rregull dhe do ta mbështesnim këtë dokument për të vazhduar më tutje.

Çështja tjetër, është jo e mirë për të shprehur por e mirë për tu thënë që nëse nuk është konsultuar nga Drejtoritë përkatëse, askush, qytetarë, shoqata, komitete konsultative, komisione të brendshme dhe të jashtme, apo edhe ekspertë ndryshëm, dhe fillon të implemenohet kjo Kornizë, atëherë mirë na e koftë qoftë neve qoftë edhe qytetarëve në përgjithësi.

Duke pas parasysh që KAB është dokument kryesor i rëndësishëm, për shkak të obligimit ligjor, duhet të mbështetet në parim dhe e mbështesim ngase nuk mund të thuhet jo, veç që nuk jemi në pushtet nuk do ta mbështesim, veç pse e ka përgatitur dikush që është në pushtet. Pra në parim e mbështesim, por dëshiroj që para se të hedhet në votim të paktën ndokush nga Ekzekutivi të na jap informata rreth kryerjes së obligimeve konsultative nga ana e Drejtorive me akterët që i ceka më lartë, mos të merret kjo obligativisht por me qëllimin më të mirë që dokumenti në fjalë të shtyhet përpara, kurse vërejtjet dhe plotësim ndryshimet do t'i japim në qarkoret e radhës ku do të mund të japim propozime të projekteve. Nëse askush nga akterët që i ceka nuk kërkon llogari nga Ekzekutivi, nuk do të ishte as në interes tonin si Kuvend ta ndalim këtë dokument për arsye se qytetarët e Komunës së Podujevës janë më shumë se ne 35 këshilltarët e Kuvendit që jemi dhe 11 drejtorë dhe Kryetari, andaj kjo seancë është publike, qytetarët janë të njoftuar, mandej të gjitha fushat që i ceka janë jashtë kësaj salle të Kuvendit, nëse janë konsultuar duhet ta mbështesim nëse jo është edhe forma e sanksionimit nga qytetarët.

Për fund, edhe njëherë i nderuari Kryesues, ne në parim i japim mbështetje dokumentit në fjalë nëse janë përmbushur obligimet nga ana e Drejtorive, nëse ka përgjigje ndokush, ta merr fjalën, nëse jo vazhdojmë nuk kemi çfarë të themi.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, Buxheti i komunës në bazë të planifikimeve të parashtruara në kornizën afatmesme të shpenzimeve parashihet të rritet, mirëpo rritja parashihet vetëm nga granti qeveritar, ndërsa të hyrat vetanake edhe në vlerësimet tuaja parashihen të zvogëlohen nga 1,588,175 euro në vitin 2019, në 1,416,561 në vitin 2020, që i bie 171,614 euro më pak. Ky është një tregues shqetësues dhe tregues për kahjen e zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës tonë. -Ne, LVV, në secilin projektbuxhet apo raport financiar që është paraqitur kemi konstatuar se të hyrat vetanake kanë potencial që të jenë shumë më të mëdha, madje është edhe e gjetur e auditorit se një numër i madh i pronave nuk tatimohen fare në tatim në pronë. Andaj, shtrojmë si pyetje; Në bazë të çfarë analize keni konstatuar se të hyrat vetanake do të jenë më të ulëta se në vitin paraprak për vitin 2020? Tek të hyrat komunale mund të lexohen edhe problem tjera dhe kontradikta në këtë kornizë afatmesme të shpenzimeve. Tek të hyrat nga lejet e ndërtimit parashihet që në vitin 2020 të hyrat të jenë 180,000 euro, pra 40,000 euro më pak se në vitin 2018 që tregon se edhe në bazë të këtij dokumenti nuk parashihet zhvillim urban i qytetit as rritje e aktivitetit biznesor për arsye se nuk parashihet ndërtim e pa ndërtim nuk ka zhvillim. -Tek shpenzimet komunale për paga dhe mëditje shtrohet pyetja; a i keni inkuadruar ndryshimet të cilat i sjellë ligji i pagave? Në bazë të ligjit të ri të pagave përpos që ka rritje të pagave në të gjithë sektorët publikë parashihet që për vitet e ardhshme të ketë rritje të pagave në bazë të rritjes ekonomike. Rritja ekonomike parashihet të jetë afër 4,5%

ndërsa në kornizën afatmesme të shpenzimeve pagat dhe mëditjet janë të planifikuara proporcionalisht për tri vite në vlerë prej 14,013,981 euro dhe që padyshim është e gabuar. -Tek mallrat dhe shërbimet për tri vite parashihet shuma e njëjtë e shpenzimeve prej 2,219,352 euro që shihet qartë që vetëm janë kopjuar shifrat, dhe ky është një tregues shtesë për nivelin shumë të dobët që është përpiluar ky dokument. Ne mendojmë që të ketë rritje të buxhetit në kategorinë e mallrave me theks të veçantë në furnizimet për nevojat e shtëpive të shëndetit dhe shkollave me materiale të nevojshme që hyjnë në kategorinë e mallrave. -Tek investimet kapitale edhe për këtë periudhë është planifikuar që mjetet të investohen aty ku ka kthim më të madh nga tenderët për interesat personale e jo aty ku investimet kanë një ndikim më të madh në zhvillimi e gjithmbarshëm ekonomiko-shoqëror në interesat e të gjithë qytetarëve.

z.Benjamin Hoti, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore e cila është dokument strategjik i Komunës së Podujevës që parashihet dhe është i programuar, i shkruar dhe i hartuar në mënyrë profesionale që parashihet zhvillimin e Komunës së Podujevës në përputhje me hapësirën buxhetore që ka si dhe kërkesave të qytetarëve.

Dokumentin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2020/2022 secili prej nesh e kemi pasë para vetës dhe kemi parë mundësitë dhe format se si do të bëhen investimet e parapara nga Komuna e Podujevës. Vlen të ceket se lajm i mirë është për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit e cila ka paraparë hapësira sportive dhe fusha të hapura në komunitet, kërkesë kjo e qytetarëve të Komunës së Podujevës, e që në takimet e vazhdueshme që kemi ne si të rinj me qytetarë, është shfaqur kjo kërkesë. Po ashtu kjo Drejtori ka paraparë edhe inventarin e ri për objektin e Bibliotekës, si gjë shumë e nevojshme për Komunën e Podujevës dhe investim shumë me vend, për dallim prej disave që para disa muajve kërkonin që librat e Bibliotekës të barten nëpër korridoret e shkollave dhe që nuk ia dinë dhe nuk kanë idenë se në çfarë forme duhet vepruar me librin dhe si duhet trajtuar ai, ndoshta pa qenë edhe në dijeni se Biblioteka e Podujevës ka mbi 40000 ekzemplarë librash dhe që e gjithë ajo literaturë nuk mund të trajtohen brenda 2 javëve nëpër hapësira jo të përshtatshme.

Vlen të ceket se edhe Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të rinjve të cilët dëshirojnë të merren me bujqësi, po iu jepet hapësirë dhe mundësi për ta zhvilluar këtë veprimtari shumë përfituese për ata. Në çdo ditë që unë takoj të rinj-bujq të cilët punojnë, janë fermer të suksesshëm dhe u janë falënderues Komunës së Podujevës përkatësisht Kryetarit z.Agim Velu, për shkak se ata janë ndihmuar me fonde të ndryshme dhe subvencionime të ndryshme, e që dikujt këtu iu pengon kjo dhe fillojnë të bëjnë edhe zhurmë ngase me të vërtetë këto i vrasin dhe iu pengojnë atyre,. Prandaj po dëshiroj të them se zhvillimi i Komunës së Podujevës është në drejtim të duhur dhe për këtë arsye, zhvillimi i mirë, punët e mira dhe suksesi i madh i Komunës së Podujevës bën që Lidhja Demokratike e Kosovës, të mbajë dhe të udhëheqë tash e sa vite.

z.Adnan Zymeri, theksoi, ashtu siç është edhe zakon, kur dokumente të tilla sjellën për shqyrtim në Kuvend, që përcaktojnë sektorë dhe projekte prioritare për orientim dhe zhvillim të Komunës, në diskutimet ndryshojnë tonin e zërit si për të treguar një lloj dominancë mbi mendimin e pozitës, mirëpo nuk duhet harruar që mirë orientimi dhe gjithë përfshirja në ndarjen buxhetore duke lënë hapësira për inputet e opozitës, ka bërë që LDK e Llapit e udhëhequr nga Kryetari z.Agim Velu të marrë rezultatin për të cilin jeni të informuar.

Sa i përket KAB 2020/2022, nga ajo që është prezantuar nga të gjitha dikasteret e qeverisjes lokale, janë paraparë projekte të cilat përmbushin në substancë misionin e Komunës që është ofrimi i një jete më të mirë për qytetarët e saj, duke filluar nga projekte infrastrukturore deri tek bujqësia e cila me të drejtë konsiderohet si shtylla e zhvillimit ekonomik lokal. Dimension tjetër të cilit duhet t'i kushtohet rëndësi, meqë Qeveria e Republikës së Kosovës nuk po e kryen detyrën e saj, është gjetja e mundësive për partneritete publiko private, të çfarëdo forme që do të mundësonin angazhimin e të

rinjve në tregun e punës. Element tjetër i rëndësisë së veçantë për zhvillimin dhe angazhimin e të rinjve është edhe themelimi i një qendre të inovacionit, e që realisht do të duhej të ishte angazhim primar i Ministrisë së Inovacionit, mirëpo siç jeni në dijeni ata kanë qenë të angazhuar me disa çështje tjera kohën e fundit, prandaj si Komunë që kemi duhet të iniciojmë themelimin e një qendre të tillë, në dakordancë dhe me përgjegjësi primare të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit si dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, mora fjalën me qëllim të replikës ndaj diskutimit të kolegut parafolës z.Benjamin Hoti i cili ndër të tjera e tha që gjoja ne nuk dimë se si ta trajtojmë librin, mirëpo unë i them atij se deri tani është vërejtur mjaft mirë se si është trajtuar libri nga ju duke qëndruar nëpër podrume që 1 vit dhe duke mos e sjellë nëpër objektet e Komunës, të pashfrytëzuara. Sa i përket prioritetit të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Komuna e Podujevës vetëm 1% e ka prioritet këtë Drejtori gjatë këtyre viteve.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, theksoi, dëshiroj të jap disa sqarim, të nderuar me 15 maj 2019 Ministria e Financave ka lëshuar Qarkoren Buxhetore 2020/01, dhe menjëherë kemi filluar përgatitjet për përgatitjen e dokumentit kornizë që KAB 2020/2022 e Komunës së Podujevës.

Janë bërë konsultimet e brendshme, janë mbajtur edhe dëgjime buxhetore me publikun pikërisht në këtë sallë dhe janë marrë kërkesat e tyre e që mbi 97% kanë qenë kërkesa vetëm për asfalt dhe kanalizim, madje mund t'i shihni edhe në procesverbal se kush dhe çfarë ka kërkuar, por megjithatë Ekzekutivi i Komunës, në bazë të politikave të veta ka përfshirë edhe sfera tjera të cilat kanë qenë me interes për Komunën e Podujevës, gjithnjë në bazë të buxhetit të përcaktuar dhe që është në dokumentin bazë-KAB.

Unë me gjithë kënaqësinë më të madhe do të rritja buxhetin (10 fishin e këtij aktual), për subvencione në secilin sektor, ashtu siç kërkoi këshilltarja nga radhët e LVV-së, sikur të mos kishim përkufizime buxhetore që i përkufizon edhe Qarkorja por edhe KAB, pra nuk jemi ne ata që planifikojmë ashtu siç dëshirojmë si dhe nuk kemi mundësi të rrisim buxhetin sepse do ta bënim një gjë të tillë, shembull për investime kapita do ta rritja edhe për 5 milion euro, dhe do të përfshija edhe ato propozime që u dhanë deri tani.

Sa i përket të hyrave vetanake, në përgjithësi në këtë vit ka ndryshuar planifikimi i të hyrave në nivel Kosove. Deri në 2019, Ministria e Financave ka marrë planifikimet e Komunave, dhe zakonisht ka ndodh që ato planifikime të rriten për nga 200-300 mijë euro, në mënyrë që të plotësohen kufijtë e grantit të përcaktuar në nivel vendi, ndërsa në këtë vit ka ndryshuar qasja e planifikimit të të hyrave për Komunitat ku Ministri i Ministrisë së Financave paraprakisht ka nxjerrë një vendim me të cilit thotë që Komunitat duhet të planifikojnë të hyrat duke marrë për bazë historiatin e realizimit të të hyrave vetanake në tri vitet e fundit dhe të nxirret një mesatare e atij realizimi, dhe pastaj të merret për bazë ai planifikim në mënyrë që të jetë më shumë i realizueshëm, të paktën në kufijtë e lejuar. Pra në nivel vendi për Komunitat, të hyrat në grant të përgjithshëm janë planifikuar me një zvogëlim prej 10 milion euro, kështu që edhe Komuna jonë ka një zvogëlim të të hyrave të planifikuara por që nuk na pengon neve asgjë që të inkasojmë sa më shumë të hyra dhe ta rrisim buxhetin sërish dhe si rrjedhojë ato të hyra ti vendosim në projekte të ndryshme dhe kategori të ndryshme varësisht siç e planifikojmë ne. Pastaj dëshiroj të jap edhe një element se si kjo ndikon edhe tek tatimi në pronë i cili sipas ligjit që ka qenë deri tani, automatikisht është amortizuar për 10,000.00€, kurse tani me Ligjin e ri çdo objekt banimi amortizohet për 15,000.00€, dhe sipas kësaj nëse i marrim të gjitha pronat të cilat kushtimisht e them nëse janë individuale, në faturat e tatimit në pronë vlera e tyre nga ky do të jetë për 5,000.00€ më e vogël dhe rrjedhimisht edhe tatimi do të jetë më i vogël. Kur jemi në këtë temë shfrytëzoj rastin të bëjë thirrje tek të gjithë qytetarët të cilët i kanë të regjistruara shumë prona të tyre në emër të një pronari e që realisht mund të mos jenë të tyre por të vëllezërve të tyre

apo ndonjë personi tjetër, gjë e cila është traditë tek ne në një formë, po e jap si vërejtje ngase nuk përfitojnë në këtë zbritje të tatimit të gjitha pronat nëse një pronar ka të regjistruar shumë prona, por amortizim përfiton vetëm një pronë, kështu që bëjë thirrje që t'i regjistrojnë pronat në emër të atyre që faktikisht i kanë në emër të tyre, në mënyrë që të përfitojnë secili në amortizim.

Pra kjo është një gjë shumë e mirë që e ka paraparë ligji, andaj përse të mos përfitojnë të gjithë qytetarët, andaj edhe e ceka edhe pse ne kemi dhe vazhdojmë të bëjmë thirrje përmes mediave lokale me reklama, por që ndoshta ende nuk po jenë të informuar sa duhet qytetarët ngase është direkt përfitim i qytetarëve nga ligji, për Komunën zvogëlim i të hyrave, por meqë është përcaktuar ashtu me ligj përse të mos përfitojnë qytetarët.

z.Fitim Haziri, theksoi, më shtyri Drejtori parafolës që të marrë fjalën dhe të replikoj, kjo qeveri siç po shihet që nga pas lufta mendësia e saj është që nuk mund të dal përtej asfaltit dhe kanalizimit dhe është shqetësuese që nuk dinë që qytetarëve të Komunës së Podujevës t'i ofrojnë projekte të cilat do ti përkrahnin ata vetë, por vazhdimisht atyre ju janë paraqitë asfalt-kanalizim.

Të gjitha ato propozime që LVV i propozoj do të ishte e realizueshme sikur ju do të planifikonit ashtu qysh është më së miri në projekte të ndryshme në sfera të ndryshme që ti paraqiten qytetarëve të Komunës së Podujevës. Ju sikur ti kishit edhe 500 – 600 milion euro, nuk do të dinit ti shfrytëzoni për qytetarët e Komunës së Podujevës, kjo tregon shumë se nga buxheti për investime kapitale në vitin e kaluar sa ka qenë i realizueshëm, ka qenë 68% vetëm, sepse nuk dini as me planifiku as nuk dini me punu.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, theksoi, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Podujevës është në fazën e hartimit dhe përgatitjes. Buxheti i ka kufizimet e veta, dhe nuk qëndron ajo kinse ne nuk dimë të planifikojnë, por janë edhe disa faktor tjerë, mbështetjen nga Qeveria qendrore e kemi zero dhe këtë e mbështes në atë që nuk institucion në nivel qendror që nuk kemi bërë përpjekje, të vëm kontakt dhe të kërkojmë mbështetje për secilin projekt që ata e kanë zhvilluar në nivel Kosove, por që në asnjë institucion të nivelit qendrorë nuk kemi gjetë mbështetje për programe zhvillimore, qoftë ne si Komunë qoftë si rajon i Llapit.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, theksoi, më nxiti fakti që personi paraprak (këshilltari i Kuvendit) e bëri një përkrahim duke thënë që ne jemi të paaftë, mirëpo unë dëshiroj ta njoftoj atë dhe njëkohësisht e ftoj publikisht z.Fitim Hazirin që të hënën të vie në zyrën time dhe të qëndroj për 8 orë, dhe nga këtu i garantoj që të paktën 80 perona do të vijnë në zyrë dhe do të kërkojnë rregullim të infrastrukturës. Unë jam në dijeni se një pjesë e juaj e kenë të rregulluar infrastrukturën në ato lokalitete ku jetoni dhe tani menjëherë tentoni t'i shpërndani mjetet buxhetore sipas dëshirave tuaja. Edhe ne kemi dëshirë që të kemi edhe 10 milion euro vetëm për bujqësi dhe t'ju japim subvencione qytetarëve, edhe pse duhet pasur parasysh që ende nuk e kemi të rregulluar në tërësi infrastrukturën, por edhe një herë e përsërisë që rreth 99% e qytetarëve tanë i paraqesin kërkesat e tyre për rregullim të infrastrukturës, madje ka kërkesa edhe për 15 m, gjatësi, qoftë asfalt, kanalizim etj.

Unë personalisht ju them se për të gjitha fshatrat e territorit të Komunës së Podujevës jam në dijeni rreth gjendjes momentale të infrastrukturës, madje po ju tregoj vetëm dy raste, fshati Metergoc është në pjesën e fundit të rajonit të Llapit, në pjesën jug-lindore dhe sigurisht jeni në dijeni për gjendjen e infrastrukturës si është atje ku ende qëndron rruga rreth 10 km e pa asfaltuar dhe që kërkohet vazhdimisht të asfaltohet, dhe ne për vitin e ardhshëm kemi planifikuar që fillimisht afër 4 km ti asfaltojmë me të vetmin qëllim dhe duke pasur parasysh që në atë pjesë gjenden 6 ferma me mbi 250 krerë lopë, dhe që ata pronar nuk kanë mundësi ta bartin qumështin në fshatin Orllan për shkak të rrugës jo të asfaltuar, madje ka mundësi që qumështi t'i priset dhe ta hedhin. Pra po ju tregoj ngase

ju keni vetëm një seancë në muaj si dhe bisedoni me një rreth të ngushtë që ju rrethon, kurse ne kemi kontakte për çdo ditë me qytetarë të lokaliteteve të ndryshme dhe kemi kërkesa dhe paraqitje të nevojave nga më të ndryshmet, dhe për gjendjen që kemi si Komunë, e them këtë sepse Komuna e Podujevës është me territorin më të madh në gjithë Kosovën, pastaj kemi infrastrukturën më të madhe nga të gjitha Komunitat, andaj t'i kemi parasysh edhe këto.

Unë ju ftoj ta formoni një Komision prej Kuvendi dhe të dalim bashkërisht të shikojmë nga afër secilin prej këtyre projekteve që janë përfshirë në KAB. Do të doja që të kemi dyfishin e këtij buxheti për investime në infrastrukturë. Pastaj kemi edhe fshatin Kushevicë që po ashtu ka rreth 7 km rrugë të paasfaltuar dhe në një gjendje jo të mirë, por që kemi planifikuar që të asfaltojmë fillimisht 2 km në mënyrë që t'ju bëjmë të mundur qasjen me Orllanin.

Unë i kuptoj edhe pjesën tjetër të kërkesave, por urdhëroni ejani bashkërisht të rregullojmë infrastrukturën dhe ta zhvillojmë sa më shumë Komunën e Podujevës, por jo vetëm të shikoni zi, por ejani të shikojmë edhe ngjyrat tjera sepse ka mjaft që natyra i ka krijuar, nuk është vetëm e zeza.

Për asnjë kërkesë të paraqitur nuk e them që nuk është e drejtë, por prioritet i prioritetëve për qytetarët është infrastruktura, madje edhe parandalohet shpërngulja nga fshatrat, pastaj krijohen mundësi për t'i ndihmuar bizneset.

Rreth asaj që parafolësi z.Fitim Haziri e tha që nuk ka profesionalistë, unë i them atij që në Podujevë asnjë nuk e keni më profesionalistë se unë, dhe kjo është shumë reale ta them sepse ashtu është, dhe këtë mund t'juja dëshmoj, vetëm gjeni kohë dhe dalim bashkërisht në terren.

Këto planifikime që janë paraparë në këtë KAB, ju garantoj se janë 100% kërkesa të qytetarëve, e të cilat ne duhet ti realizojmë. Kurse sa i përket asaj që u tha se në vitin e kaluar nuk është realizuar i tërë buxheti, është reale ngase në infrastrukturë, sidomos në qytet janë paraqitur mjaft vështirësi sepse nuk kemi të dhëna për infrastrukturën nëntokësore se si është për shkak se është punuar me vite të tëra dhe nuk ka informata e as shënime, dhe ka mundësi të ketë pengesa të ndryshme, kurse për pjesën tjetër nuk ka asnjë pengesë.

Edhe njëherë ju ftoj që bashkërisht të japim kontributin secili prej nesh ngase ky dokument dhe këto projekte ende nuk janë përfundimtare dhe ka kohë deri në fund të muajit shtator të bëhen korrigjime, plotësime dhe ndryshime eventuale, gjithnjë në interes të qytetarëve.

(Kryesuesi i Kuvendit, ia tërheq vërejtjen një përfaqësuesi – kameramani të një mediumi lokal, për sjellje jashtë standardeve të gazetarisë gjatë zhvillimit të seancës, shkaktim të zhurmës dhe mos respektimit të kodit etik të veshjes).

z.Fitim Haziri, theksoi, shqetësimin që e ngrita vërtetë është keq që për 20 vite në Komunën e Podujevës vazhdimisht ka investime në infrastrukturën rrugore. Pastaj ne mund të flasim edhe rreth standardeve që punohet në këtë infrastrukturë, e që janë punime me standarde me cilësinë më të dobët, prandaj i nderuar Drejtor, meqë jeni aq profesionist, përse kur ta shtroni një rrugë, nuk e shtroni ashtu siç kërkohet qoftë në trashësi të asfaltit qoftë në gjerësi, e jo të bëni rrugë si të jenë shtigje për biçikleta sepse jemi në shekullin XXI, dhe asfaltohen rrugë me 3 m gjerësi, e që kjo është e papranueshme sa i përket standardeve që ju i praktikoni, madje ka rast kur ende pa u bërë 24 orë prej asfaltimit të një rruge dhe ai asfalt ka dështuar, është prishur.

Pra mendësia juaj është vetëm për asfalt dhe kanalizim, ju nuk i ofroni projekte qytetarëve të Komunës së Podujevës të cilat janë zhvillimore dhe që janë kërkesa të tyre, por vetëm asfalt e që mendoj se arsyeja që jeni përqendruar vetëm në asfalt është se sigurisht aty po e keni edhe leverdinë.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, theksoi, unë sigurisht do të anashkaloj anën e profesionalizmit dhe çështjeve tjera që u ceken sepse janë çështje që vlerësohen nga të tjerët e jo në këtë formë politike kështu.

Këshilltari z.Rafet Llapashtica me të drejtë pyeti rreth konsultimeve me komitete të ndryshme, me theks Komitetet konsultative, unë ju njoftoj se kemi pas takim me Komitetin konsultativ për shërbime publike planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit, dhe vërtetë kam qenë i kënaqur me angazhimin e tyre dhe ju kam premtuar që pas draftit të parë të KAB-it do të njoftoj atë Komitet për të gjitha projektet e Drejtorisë për tri vitet e ardhshme, kjo ngase kam vërejtur që ai komitet ka mundësi të na ndihmoj në këtë aspekt.

Sigurisht ata që dëshirojnë mund të vërejnë që struktura e projekteve në kuadër të shërbimeve publike ka ndryshuar kurse vetëm ata që nuk e shikojnë dhe nuk e analizojnë mund të thonë të kundërtën, shembull kanalizim etj, pra shihet se kemi kaluar në faza tjera siç janë kolektorët në fazë të dytë, janë trotualet, është ndriçimi publik etj të ngjashme.

Sinqerisht ju them se jam munduar që të gjitha kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e fshatrave dhe qytetarëve t'i përfshij në planifikime buxhetore, sepse ne kemi informata të mëdha ngase jemi në terren, kemi mbajtur debate publike, si dhe jemi në kontakte me qytetarë pothuajse çdo ditë, mirëpo do të mundohemi që edhe kërkesa tjera që do të paraqiten deri në muajin shtator, ti përfshijë në planifikime buxhetore të Drejtorisë. Struktura buxhetore është paksa problematike sepse me Qarkore dhe dokumente tjera të nivelit qendrorë, nuk po na lejohet të veprojmë si dëshirojmë ne, në të kundërtën ne do t'i orientonim shumë projekte në subvencione dhe kategori tjera më shumë zhvillimore por jemi të obliguar të respektojmë ashtu siç është, pra jemi paksa të hendikepuar për të kaluar në projekte tjera zhvillimore megjithëse edhe infrastruktura është pjesë zhvillimore.

Për fund, deri në muajin shtator planifikimet DSHPMSh-së janë të hapura për projekte infrastrukturore dhe të shërbimeve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën, urdhëroni, nëse jo e vë në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020/2022 të Komunës së Podujevës, duke përfshirë konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 26 qershor 2019, dhe korrigjimeve, plotësim ndryshimeve të kërkuara nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në fjalën hyrëse;

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota për, 10 vota kundër, 7 vota të përmbajtura, u miratua Korniza Afatmesme Buxhetore 2020/2022 e Komunës së Podujevës, sipas materialit të dërguar, konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe me korrigjimin e disa gabimeve teknike të paraqitura në fjalën hyrëse nga Drejtori i DBF, përkatësisht;

Tek faqe 21, projekti me nr.4

"Asfaltimi i disa rrugëve e rrugicave neper lagjet e ndryshme te qytetit; Asfaltimi i disa rrugëve e rrugicave ekzistuese me shtresë te dyte (-II-) te asfaltit me trashësi 4 cm si dhe hartimi i projekteve (vazhdim).", ndryshohen shumat si vijon: Granti -109,124; Të hyrat vetanake - 30,000; Totali - 139,124

Tek faqe 28, rubrika e Kulturës, shtohet edhe një projekt, dhe atë:

3-Muze dhe Galeri (brenda objektit të tanishëm të Komunës), Granti – 26,000; Të hyrat vetanake – zero; Totali – 26,000.

3. Propozim vendimi për vënie diskutim publik propozim Rregulloren për Orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, propozim rregulloja për Orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, është e bazuar në minimumet dhe maksimumet kohore të përcaktuara në ligjet përkatëse në fuqi.

Është kërkesë dhe kriter kryesor nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që aktet e tilla para shqyrtimit përfundimtar dhe vendosjes, të prezantohen si drafte fillimisht në Kuvend, t'i jepet pëlqimi për diskutim dhe debat publik me qytetarë dhe grupe të interesit.

Ne si DPZHE do të organizojmë takime me sektorë, shoqata dhe organizata të ndryshme biznesore dhe do t'i marrim parasysh të gjitha kërkesat e arsyeshme të tyre konform specifikave të tyre që kanë ku pastaj do të harmonizohen në dokumentin final i cili do të sjellët sërish në këtë Kuvend për shqyrtim final.

Me këtë draft Rregullore tentohet të vëhet një rregull, gjithnjë në interes dhe në të mirë të qytetarëve, mirëpo njëkohësisht duke pas parasysh mos dëmtimin e aktiviteteve dhe veprimtarive biznesore që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës. Ne jemi të hapur për çdo sugjerim, propozim dhe këshillë nga secili qytetarë me qëllim që dokumenti final të jetë sa më cilësor dhe sa më i kompletuar në këtë fushë, andaj edhe ftoj të gjithë për bashkëpunim.

Sa i përket kohëzgjatjes së diskutimit dhe debatit publik kemi paraparë që të jetë nga 01.07.2019 deri më 31.07.2019, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 15.07.2019 në ora 10:00, duke mos përjashtuar edhe takime konsultative gjatë kësaj periudhe me grupe të ndryshme të interesit, me qëllim që finalizimi i saj të jetë sa më i kompletuar dhe harmonizuar me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve dhe grupeve të interesit, pastaj me miratimin e saj në Kuvend dhe futjes në implementim, do të shfuqizohet rregullorja përkatëse paraprake, kurse mbarëvajtëse e zbatimit të kësaj rregulloreje do të jetë Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me akterët tjerë relevant.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush është i interesuar të marrë fjalën, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim rregullores për orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së, përkatësisht që kohëzgjatja e diskutimi publik të zgjatë nga 01.07.2019 deri më 30.07.2019, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më 15.07.2019 në ora 10:00.

4. Informatë e Drejtorisë së Arsimit – Organizimi i garave në Komunën e Podujevës në kuadër të Programit Nacional për Rini

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me një informatë që ka kërkuar një Grup i këshilltarëve të Kuvendit në mbledhjen e kaluar të Kuvendit. Drejtoria e Arsimit e ka përgatitur, për çka e falënderoj Drejtorin, dhe e njëjta ju është shpërndarë të gjithë këshilltarëve të Kuvendit së bashku me thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhjeje, andaj e hapim diskutimin.

z.Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, e paraqiti informatën, ndër të tjera theksoi, organizimi i garave në kuadër të programit nacional për rini, organizohet në bazë të planit të veprimit të Koordinatorit nacional për kulturë, rini dhe sport, Vendimit të Kryeministrit me nr.prot.07/03 me të cilin është miratuar ky plan i veprimit si dhe në bazë të Marrëveshjes së

Bashkëpunimit të nënshkruar nga Komuna e Podujevës dhe Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport. Gjatë muajve shkurt dhe mars 2019 janë zhvilluar gara në kreativitet kulturorë dhe mendim kritik në nivel shkolle ku kanë marrë pjesë të gjithë nxënësit e Komunës së Podujevës ku janë përzgjedhur 2300 nxënës fitues nga klasa e I-rë deri në klasën e XXII-të, të cilët pastaj kanë vazhduar garën në nivel komunal gjatë muajit prill ku DKA ka formuar një panel profesional në përbërje prej profesionistëve të fushave të caktuara me qëllim që të bëjë vlerësimin e punimeve të nxënësve në këtë garë. Në garën komunale për kreativitet kulturorë dhe mendim kritik në Komunën e Podujevës janë përzgjedhur gjithsejtë 39 nxënës të cilët e kanë përfaqësuar Komunën e Podujevës në garat në nivel të Republikës së Kosovës.

Drejtorja e Arsimit në bashkëpunim me të gjithë Drejtorët e shkollave kanë bërë të gjitha përgatitjet në mënyrë që ky proces të vazhdojë ashtu siç është planifikuar dhe kështu edhe ka ndodhur, kurse me 07 maj 2019 nga Koordinatorin nacional për kulturë, rini dhe sport kemi pranuar një e-mail me të cilën jemi njoftuar për mbajtjen e garës së diturisë dhe organizimin e testit të garës nacionale të diturisë si dhe ka qenë i bashkëngjitur edhe udhëzuesi për organizimin e testit të diturisë dhe detyrat dhe përgjegjësitë e secilit aktor të përfshirë në këtë proces, pika 1.1. e udhëzuesit për mbarrëvajtjen e garës nacionale të diturisë, thotë, citoj; testet shpërndahen nëpër shkolla nga Koordinatorin nacional për kulturë, rini dhe sport dhe do të pranohen nga drejtorët e shkollave. Me të marrë këtë informatë kemi bërë të gjitha përgatitjet, kemi njoftuar drejtorët e shkollave të cilët i kanë njoftuar nxënësit dhe mësimitdhënësit dhe kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, të cilët edhe përkundër faktit që kanë qenë ditë e shtunë - vikend, ju kanë përgjigje ftesës të gjithë mësimitdhënësit dhe nxënësit e shkollave, pra kanë shprehur gatishmëri për organizimin e këtyre garave, mirëpo testet nuk kanë arritur dhe për pasojë të saj gara e diturisë në nivel shkolle nuk është mbajtur.

z.Fatmir Rudari, theksoi, unë pajtoj me Drejtorin e DKA-së për pjesën e parë të informatës i cili e tha se nxënësit e Komunës së Podujevës në mendim kritik kanë arritur një rezultat shumë të mirë, por nuk pajtoj me pjesën e fundit të kësaj informate. Testi i diturisë ka qenë i planifikuar të mbahet më 11 maj 2019, dhe tani jemi në 28 qershor dhe ende nuk kemi asnjë informacion nga ana e Drejtorit, përse nuk është mbajtur ai test. Pra do të thotë, mbi 19000 nxënës dhe mbi 1000 mësimitdhënësit ju kanë përgjigje kësaj thirrje të Drejtorit, kurse ky deri sot nuk ka dhënë asnjë informatë përse nuk është mbajtur testi i diturisë në Komunën e Podujevës, ndërsa sot ceket pika 1.1. të udhëzuesit sipas të cilit është dashtë Koordinatorin të shpërndajë testet nëpër shkolla.

Ka informata që qarkullojnë se testet kanë ardhur në Komunën e Podujevës rreth orës 2:00 pas mesnate, çështje për të cilën ndoshta mund të na informojë edhe Drejtori i Drejtorisë së Administratës së kush i ka pranuar ato teste, në fakt thuhet që një roje e natës i ka pranuar, dhe përse ju si drejtor nuk jeni të informuar, madje nëse keni qenë në dijeni se testet nuk janë ardhur është dashtë t'i lajmëroni nxënësit që mos të shkojnë në shkolla sepse nuk ka teste, ashtu siç kanë vepruar disa shkolla në Prishtinë të cilave ju janë shpërndarë testet natën por që nuk i kanë pranuar me arsyetim që nuk mund të organizohen për atë kohë të shkurtë, ndërsa ti drejtor i ke thirrë mbi 19000 nxënës dhe mbi 1000 mësimitdhënësit të cilët në ditën e shtunë – ditë vikendi kanë dalë nëpër shkolla, dhe nuk ka kurrfarë llogarie fare. Pra ju si drejtor duhet të jepni sqarime, a janë ardhur testet apo jo, edhe pse unë kam informata se testet janë ardhur në objektin e ri të Komunës dhe janë pranuar nga një roje e natës rreth orës 2:00 pas mesnate, kurse kanë mbetur aty.

z.Agim Blakçori, Drejtor i DKA, theksoi, ato që parafolësi i cekur, disa prej tyre qëndrojnë pjesërisht. Përse nuk keni marrë informacion ju është se nuk e kemi pas të kuartit as ne, për arsye se jemi kontaktuar përmes telefonit nga Zyra e Koordinatorit duke na porositur të jemi në gjendje gatishmërie ose drejtorët e shkollave ose dikush nga stafi i shkollës se mund të arrijnë teste edhe gjatë natës në shkolla, e që ne kemi pranuar që testet të pranojmë edhe gjatë natës me të vetmen arsye

që nxënësve tanë t'jua mundësojmë të marrin pjesë në garën e diturisë, pastaj ne kemi pritur edhe në mëngjes që testet të sjellën dhe kjo madje ka qenë arsyeja që nuk i kemi njoftuar nxënësit dhe mësimitdhënësit të mos shkojnë në shkolla fare ngase informatat janë dërguar me kohë nëpër shkolla tek drejtorët e shkollave të cilët kanë qenë të njoftuar edhe me udhëzuesin përkatës ngase me atë janë përcaktuar edhe detyrat e drejtorëve të shkollave edhe të mësimitdhënëseve dhe të gjithë të tjerëve. Andaj plotësisht e them që për shkak të papërgjegjësisë së organizatorëve, ka dështuar organizimi i testit të diturisë në Komunën e Podujevës, për çka ndjej keqardhje qoftë për nxënësit qoftë për mësimitdhënësit si dhe shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë mësimitdhënësit të cilët në ditë vikendi janë mobilizuar, janë përgatitur dhe ju kanë përgjigj thirrjes sonë, por ne kemi besuar dhe shpresuar që deri në momentin e fundit do të sjellën testet, madje unë personalisht me të gjithë stafin kemi qenë të angazhuar qysh nga mëngjesi atë ditë, pa pasur informacionin se çfarë po ndodh me testet, kemi provuar t'i kontaktojmë Zyrën e Koordinatorit por nuk na kanë hapur telefonat, prandaj në një formë mund të them se kemi qenë në terr informativ se çfarë po ndodh.

Se a kanë ardhur testet apo jo nëpër objekte tjera, atë informacion nuk e di.

z.Fatmir Rudari, theksoi, në fakt ne të gjithë ndjejmë keqardhje për nxënësit të cilët nuk kanë mund t'i shprehin aftësitë e tyre edhe në këtë garë e që besoj se do të dilnim shumë mirë me sukses ashtu siç kemi dalë edhe në gara të tjera. Unë nuk po e mbroj as nuk po e bëj të mirë Koordinatorin nacional për kulturë, rini dhe sport sepse është dashur të ketë koordinim më të mirë ngase është përgjegjësi të thirresh 19000 nxënës nëpër shkolla dhe mos të sjellësh testet fare, por ju si drejtor është dashur të dilni menjëherë me sqarim dhe të thoni kjo është arsye përse nuk është mbajtur testi, nuk janë sjellë testet, por për gjithë këtë kohë deri më sot kur jemi më 28 qershor, kjo çështje ka provuar të kalojë në heshtje dhe të mbyllet si çështje.

Ne si mësimitdhënës ju kemi përgjigje ftesës, po ashtu edhe nxënësit, kemi dalë nëpër shkolla dhe kemi pritur deri në ora 11:00 të paradites.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e konstatoj të mbyllur këtë pikë.

5. Të ndryshme

z.Arbër Blaku, theksoi, i kam dy çështje për t'i shtruar, 1-kam një kërkesë prej z.Shaip Cakaj së bashku me vëllezër dhe familjar të cilët na janë drejtuar lidhur me asfaltimin e një rruge të lagjes së tyre në fshatin Llapashticë. I përmenduri në bazë të informatave që më ka dërguar përmes e-mailit por edhe fizikisht, nga viti 2014 është duke u sjellë nëpër zyra të Komunës lidhur me projektin.

Në atë kohë drejtor i atij shërbimi kishte qenë z.Durim Salihu. I nderuar Kryesues, unë po jua dorëzoj ty këtë kërkesë që pastaj t'ia përcjellësh drejtorit të tanishëm z.Hamdi Jaha ose Nënkrjetarit të Komunës, dhe të shohim se çka ka ndodh me një projekt që Komuna e ke shëtitë që 5 vite atë person për shkak të bindjeve politike, madje ish drejtori që e ceka e ka shti personin në fjalë që ta paguaj projektin me para të veta për të ardhur deri tek asfaltimi i saj.

2-kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit që në seancën e radhës të na raportoj për punën e Inspeksionit për vitin 2019, konkretisht për rrugën "Zahir Pajaziti" se çfarë është duke ndodh me parkingje ilegale që ne si qytetarë nuk po kemi kah të lëvizim këmbë, etj etj, por për më shumë diskutojmë në seancën e radhës.

z.Bajram Ajeti, theksoi, edhe unë dëshiroj të ndërlidhem me problemin që e paraqiti parafolësi që ka të bëjë me një lagje të fshatit Llapashticë e Epërme, Lagja Cakajt. Në fakt bëhet fjalë për një shkresë që personi i cekur na ka dërguar dhe ka dhënë disa informata se si ka vajtur puna nga viti

2014 e deri më sot. Në vitin 2014 Kryetari i Komunës i ka premtuar, problemin ia ka bartur drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit i cili pastaj ka telefonuar z. Shaip Cakajn dhe janë marrë vesh që puna do bëhet por që projekti duhet të bëhet në filan vendin, siç është traditë këtu e që edhe ju e dini më mirë se ne, ja ky është projekti ku figuron e dhe firma që e ka bërë këtë (*prezanton me foto-dokument*), dhe për këtë ka marrë 500 €, mirëpo ndërkohë ka shkuar dikush politikisht dhe i ka thënë atij personi që tek ju ka ndejë Jakup Krasniqi, Adem Demaçi dhe disa figura tjera edhe ndërkombëtare, dhe tani prit me muaj dhe prit me vite, do të thotë po bëhen afërsisht 6 vite që ajo rrugë nuk ndërtohet, thjesht e motivuar 100% politikisht, duke mos pas parasysh që ajo lagje në krye me z. Shaip Cakajn shkollës ia ka siguruar ujësjellësin, do të thotë me gjithë pronën e tij, dhe aq më keq këtu që i njëjti është një taksapagues i mirë i Kosovës, është një ndërtues i mirë, madje është duke e bërë tani objektin më të madh në Europë atë të UBT-së, prandaj të injorohet kështu në baza politike, madje duke shtyrë edhe të shpenzoj, e them këtë ngase kur ka telefonuar drejtori i DPUMM i ka thënë që projektin duhet ta bëni ju por për projekt i dërgoj unë personat, dhe kur kanë shkuar atje dy djem të rinj, pa dashur ti bëjmë transparent kush i mbulon ata dhe si dhe në çfarë forme shkojnë e bëjnë projekte të tilla sepse jemi në dijeni edhe në rastin e fshatit Lluga që personi përkatës është dëmtuar 35,000.00 € dhe ai rast është në prokurori.

Kështu që nëse Korniza Afatmesme Buxhetore, shkon me këso shkeljesh dhe me këtë logjikë të ndarjes së njerëzve në baza politike, edhe pse z. Shaip Cakaj nuk është në LVV, është qytetar i Llapit dhe i kësaj Kosove, prandaj mendoj që, edhe pse Drejtori i Urbanizmit nuk qenka këtu prezent, desha ta pyes për rrugën në drejtim të fshatit Sfeçël që tani është gërryer, sa kërkesa ka pas për atë rrugë, apo mos ka pas vetëm kërkesën e vet personale që të gërryhet ajo rrugë dhe të bëhet edhe një shtresë asfalt sikurse që ia bëtë atëherë rrugëz “Zahir Pajaziti”.

Çështja tjetër, më 31 korrik të vitit të kaluar kemi pas mbledhje të Kuvendit dhe në rend dite kemi pas edhe Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Podujevës, e dini që vendimi për diskutim publik ka qenë i nënshkruar, ka kaluar edhe debatin publik ende nuk është sjellë për shqyrtim final dhe miratim në Kuvend. Mendoj se nuk është përgjegjësi e Kryesuesit të Kuvendit, por ai duhet të jetë këmbëngulës për akte të cilat iniciohen, votohet për ato dhe të cilat kanë hyrë në procedurë, arsyeja përse unë jam i shqetësuar lidhur me këtë është se edhe ju e dini se që 20 vite i keni kryetarët në kundërshtim me ligjin për vetëqeverisje lokale por edhe me Udhëzimin Administrativ 2008/08, madje në terren ka edhe të atillë që edhe janë të emëruar kryetar fshati edhe kryetar nëndege në po atë fshat, çështje këto të cilat nuk kanë as filozofi morale të shkohet në këtë formë, andaj bazën ligjore e kemi rreth procedurave dhe mund të veprojmë ashtu siç jemi marrë vesh këtu në Kuvend ku do të caktohet një orar i mbledhjeve nëpër fshatra ku do të marrin pjesë të gjithë të interesuarit dhe do të zgjidhen kryetarët, madje edhe në rregullore shkruan që kryetari i fshatit nuk mund të ketë përkatësi politike, kurse ju veproni sërish ashtu. Prandaj kërkoj nga Kryesuesi që të sjellët Rregullorja në Kuvend, të miratohet dhe pastaj i hyjmë procesit të zgjedhjes së këshillave dhe kryetarëve ngase vonesa e saj po më duket se është e paarsyeshme.

z. Vendenis Lahu, theksoi, mendoj se është e rëndësishme që mbledhjet e Kuvendit të jenë produktive, por për të qenë produktive duhet të jenë konstruktive, prandaj KAB është dokument i rëndësishëm për tu marrë me fjalime të dobëta dhe jo serioze. Dëgjuam këtu se si institucionet shkollore dhe arsimore fatkeqësisht dikujt i duken vende që nuk përkojnë me librin dhe kjo vie nga një këshilltarë komunal që kurrë nuk e ka ngritur zërin për gjendjen e mjerueshme në të cilën gjendet Biblioteka e qytetit dhe asnjëherë nuk e ka ngritur zërin për faktin se për kulturë rini dhe sport partia të cilës ai i shërben nuk ka ndarë asnjëherë më shumë se 2% të buxhetit, madje në këtë mandat kemi më pak se 2% të buxhetit për kulturë, rini dhe sport, dhe kjo të bënë të mendosh se ai rrallë ka lexuar

por edhe ato libra që i ka lexuar duhet t'ia kujtojmë se libri nuk e ka vetëm të lexuarit por është jashtëzakonisht edhe të kuptuarit, prandaj kjo është vetëm për sqarimin e opinionit publik sepse askujt nuk do ti japin platformë për të dal nga anonimiteti.

Kryesuesi i Kuvendit, nënvizoj, të nderuar këshilltarë, ta keni parasysh që kemi një Rregullore të punës së kuvendit, andaj kërkoj t'i përmbahemi sa i përket temave dhe diskutimeve, kjo për faktin që tani jemi në pikën Të ndryshme ku parashihet të paraqiten çështje, pyetje, kërkesa, konkrete dhe atë jo duke e zgjatë sepse është paraparë edhe kohëzgjatja, e jo të bëhen rezyme të temave që tash më kanë përfunduar me diskutime, rezymenë e paraqesë unë në cilësinë e Kryesuesit që jam, prandaj lexojeni Rregulloren nganjëherë.

z.Benjamin Hoti, theksoi, këshilltari parafolës pati një fjalim shumë mbresëlënës, por unë dëshiroj ti tregoj atij që, unë nuk i shërbej partisë për dallim siç i shërbeni ju, mirëpo unë iu shërbej qytetarëve.

z.Vendenis Lahu, replikë parafolësit, nëse ti i shërben qytetarëve atëherë përse nuk e ke ngritur zërin asnjëherë që një vit ngase qytetarët nuk kanë Bibliotekë, kurse ajo që ka qenë më parë ka qenë skandaloze, nuk ka qenë bibliotekë por ka qenë një kthinë, asgjë më shumë, kështu që nuk e di qysh iu shërben qytetarëve kur nuk i mbron interesat e tyre.

z.Mirsad Kamerolli, Drejtor i DPZHE, theksoi, sa i përket anës së profesionalizmit në DPZHE nuk do të doja të lëshohem. Unë besoj se edhe kërkesa e z.Shaip Cakajt për asfaltimin e rrugës së lagjes së tij është kërkesë legjitime duke shpresuar që në vitin e ardhshëm do të jetë prioritet. Nuk është e vërtetë ajo që u tha se projektet realizohen në baza të preferencave politike, madje sa për informatë 1 km asfaltim është duke u bërë në Lagjen Lutolli për të cilën qoftë unë qoftë Drejtori z.Faik Muçiqi e dimë shumë mirë që ata nuk kanë votuar LDK-së por kanë votuar juve personalisht (*i drejtohet Grupit të LVV-së*), mirëpo ne jemi në shërbim të qytetarëve dhe si të tillë do të punojmë.

z.Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, theksoi, mora fjalën për shkak të lakimit të emrit tim për pozitën e mandatit të kaluar që isha. Me qëllim që opinionin të ketë informatë të vërtetë, të saktë dhe reale, së pari ndjej përgjegjësi morale por edhe ligjore t'ju njoftoj se kurr, kurr nuk ka ndodh që Durim Salihu, as mandatin e kaluar, as në mandatin aktual, të marrë ndokënd në telefon, ta thërrasë ndokënd në telefon ose të kontaktoj ndokënd në çfarëdo forme dhe mënyre çoftë, t'ia kushtëzoj ndokujt diçka që të merr një projekt apo diçka tjetër të çfarëdo natyre, në bazë të preferencave kinse të Durim Salihut si ish drejtor i DPUMM apo tani si drejtor i DI.

Ata të cilët kanë argumente, sado të vogla qofshin ato, publikisht ju ftoj, hapni rastin, bëni denoncime në Prokurorinë e Shtetit, unë jam këtu dhe nuk e kam ndërmend ta lëshoj as Podujevën as Kosovën dhe jam i gatshëm sa të kem jetë të përgjigjem para çdo qytetari pa marrë parasysh ngjyrave politike, asnjëherë nuk kam bërë dallime sa i përket realizimit të projekteve sa isha drejtor i DPUMM, andaj sërish e potencoj që ata që kanë çfarëdo argumenti, unë jam i gatshëm të përballem me Institucionet përkatëse legjitime të Republikës së Kosovës, dhe për gjëra të tilla ndihem shumë krenar sepse jam shumë i pastër, kurse për ato propaganda më vie shumë mirë që sot e zbulova edhe një detaj të ri, prokuroria është duke i shqyrtuar të gjitha rastet e përmendura, mirëpo nuk ka asnjë rast të vetëm që Durim Salihu e ka vë ndokënd në lajthitje, ose i ka bërë presion, ose që e ka josh në infiltrim të realizimit të projekteve.

Kërkoj nga të gjithë që të jenë të matur në fjalën që e thonë publikisht ose në mënyrë indirekte, për arsye se ligjet vlejnë edhe për të tjerët, e jo vetëm për Durim Salihun, kështu që mos të keqpërdoren edhe ato familje të cilat mund të kenë probleme të natyrave të ndryshme, dhe tani të keqpërdoren për arsye të ndryshme, mirëpo unë ndihem ballëhapur për sjelljet, profesionalizmin dhe edukatën që e kam ndaj të gjithë banorëve të Komunës së Podujevës, dhe jam i hapur në çdo moment, kështu që edhe njëherë e përsërisë, të keni kujdes, mos shantazhoni, mos trilloni, mos shpifni pa argumente,

nëse keni argumente unë jam i gatshëm të përgjigjem në çdo situatë, në çdo moment para qytetarëve, para Kuvendit, para Institucioneve tjera vendore.

z.Bajram Ajeti, theksoi, më vie keq por me të vërtetë të jetë një njeri kështu i pa cipë dhe të paraqitet evlia kur nuk është por është djall, kjo është me të vërtetë e pa tolerueshme.

Shkresën nuk e kam shkruar unë por e kanë shkruar 5 familje, dhe vetëm një fjali po e lexoj, *pasdite më thirri drejtori* i urbanizmit Durim Salihu, pra e keni drejtuar dhe ka marrë 500€ dhe në këtë projekt është nënshkrimi juaj drejtor për atë rrugë. Tash do të përballesh me media e pse jo edhe me gjykata sepse nuk e besoj që ajo familje është e pandërgjegjshme dhe me motive tjera siç e cekët, kurse të prekësh moralin dhe dinjitetin e një familjeje shqiptare ose duhet të kesh guxim ose duhet të jesh budall.

z.Durim Salihu, Drejtor i DI, theksoi, publikisht këtu e kam edhe një kërkesë, Bajram Ajeti, mos më fyej se nuk ju kam bërë asgjë. Nuk dëshiroj të bie aq ultë me gjëra që nuk ja vlen të merremi, por është fakt që qytetarët e njohin mirë Durim Salihun, e njohin edhe prindin tim, tash të ndjerë, që ka qenë edhe ish mësimdhënësi yt, e që siç po duket nuk ka pas kënd ta mësoj, mirëpo populli e njeh mirë edhe Bajram Ajetin e vitit 1968, kaç për sot.

z.Fitim Haziri, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Administratës, dhe atë, 1-më 13.05.2019 është hap një konkurs për plotësimin e tri pozitave, më 13.06.2019 është bërë publike lista e atyre që e kanë kaluar testin me shkrim, listë në të cilën figuron renditja në bazë të alfabetit e jo në bazë të poenave, pra nuk është bërë publike se kush e ka kaluar testin me shkrim dhe në fund kanë dal tre të parët ku njëri prej tyre është anëtar i kryesisë dhe delegat i nëndegës së Letancit. Këtu vërehet se është një jo transparencë, vërehet se ka një kurdisje të këtij konkursi, andaj pyetja është përse nuk janë bërë publike poenat e fituar.

2-pytje për Drejtorin e urbanizmit, a ka leje Abulanta e Mjekësisë Familjare në Obrançë, që është ndërtuar tani në afërsi të shkollës.

3-kërkesë për Kryesuesin e Kuvendit, me qëllim të lehtësimit të punës tuaj në Kuvend, do të doja që ata persona të cilët me të vërtetë kanë bërë marrëveshje paraprake me partinë që e udhëheqë Komunën, është mirë të mos ulen në këtë pjesën këndeje por të ulen në pjesën ku edhe është pozita sepse edhe ashtu gjatë numërimit po ka probleme, pra të pozicionohen ashtu siç e ka bërë këshilltari Avni Islami, mos të përzihen këndeje ku qëndron opozita.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0052206/19
Podujevë,
28 qershor 2019**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**